



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA ELBASAN**  
AGJENCIA E PYJEVE, BUJQËSISË DHE MJEDISIT  
DREJTORIA E PYJEVE

Nr. 2656 Prot.

Elbasan, më 23 . 05 . 2024

## RELACION

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKB NR.163, DATË 27.11.2020  
“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË FONDIT PYJOR PUBLIK”  
DHE VKB NR.124, DATË 26.09.2022 “PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË  
QIRAJE TË FONDIT PYJOR PUBLIK”**

### ***Të nderuar Këshilltar!***

Struktura e Shërbimit Pyjor pranë bashkisë Elbasan, duke u bazuar në prioritetet e bashkisë Elbasan për zhvillimin ekonomik si dhe në bazë të legjislacionit në fuqi për sipërfaqet pyjore në të cilat mund të ushtrohet veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar me qëllim rritjen e të ardhurave për bashkinë të cilat përkthehen në investime në fondin pyjor, propozon dhënie në përdorim të tokës pyjore për zhvillimin e vepritarisë: *Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë.* Veprimtaria e mësipërme do të ketë një ndikim pozitiv për të ardhmen për gjenerimin e të ardhurave për komunitetin rrethues dhe rritjen e efikasitetit të prodhimit të energjisë me ndikim sa më minimal mbi mjedisin ku do të instalohet.

### **BAZA LIGJORE:**

Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,

Ligjit nr. 57/2020, dt. 30.4.2020 “Për pyjet”,

Ligjit nr. 8318, dt. 1.4.1998 “Për dhënie me qera të tokës bujqësore, pyjore të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar (neni 13,16),

Vendimit të Këshillit të Ministave nr. 433 dt.8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...”, i ndryshuar me VKM nr. 684, dt.2.9.2020.

Udhëzimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr.1, dt.9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”.

VKB nr.163, datë 27.11.2020 “Për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor publik”.

VKB nr.124, datë 26.09.2022 “Për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor publik”

Vendimi i Titullarit të bashkisë Elbasan nr.518, datë 07.05.2024 ‘Për zgjidhje kontrate’.

Vendimi i Titullarit të bashkisë Elbasan nr.519, datë 07.05.2024 ‘Për zgjidhje kontrate’.

Ndryshimi/shtesat e VKB të mësipërme vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratave të qirasë nr.6270/19 prot., datë 17.02.2021 me objekt: - Dhënie fond pyjor në përdorim, për agropylltari dhe kontratës nr.5093/14 prot., datë 19.01.2023 me objekt: - Dhënie fond pyjor në përdorim, për mbarështimin e florës së egër, kultivimin e bimëve të ndryshme, përkatësisht me Vendimet e Titullarit të bashkisë Elbasan nr.518, datë 07.05.2024 dhe Vendimi nr.519, datë 07.05.2024 ‘Për zgjidhje kontrate’.

Gjithashtu duke parë kërkesën e tregut dhe përfitimet ekonomike që mund të vijnë nga zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme në fondin pyjor publik, struktura jonë arsyeton ndryshimin e objektit të veprimtarisë për dy VKB e mësipërme, si më poshtë vijon :

1. VKB nr.163, datë 27.11.2020 kishte si objekt miratimi të saj 9 ha tokë me bimësi pyjore, në ekonominë pyjore Zalli- Shkumbin për ushtrimin e aktivitetit për Agropylltari, me vendimin e ri propozohet që sipërfaqja 9 ha objekt i kontratës së qirasë nr.6270/19, datë 17.02.2021, tashmë të zgjidhur, të jepet për ushtrimin e aktivitetit: Për vendosje panelesh fotovoltaike, me qëllim prodhimin e energjisë me afat kohor të kohëzgjatjes së kontratës 10\_vjeçare (*sipas listës bashkëlidhur*).
2. VKB nr.124, datë 26.09.2022 kishte si objekt miratimi të saj 6 ha tokë me bimësi pyjore, në ekonominë pyjore Zalli- Shkumbin për ushtrimin e aktivitetit për Mbarështimin e florës së egër, kultivimin e bimëve të ndryshme, me vendimin e ri propozohet që sipërfaqja 6 ha objekt i kontratës së qirasë nr.5093/14, datë 19.01.2023, tashmë të zgjidhur, të jepet për ushtrimin e aktivitetit: Për vendosje panelesh fotovoltaike, me qëllim prodhimin e energjisë me afat kohor të kohëzgjatjes së kontratës 10\_vjeçare (*sipas listës bashkëlidhur*).
3. Përveç kësaj duke parë që brenda pasurisë fond pyjor me nr.139, ZK 1303 me sipërfaqe totale 382840 m<sup>2</sup> ose 38,284 ha që tashmë Bashkia Elbasan është pajisur me Çertifikatë Pronësie, gjendet një sipërfaqe pyjore përgjatë rrjedhës së Lumit Shkumbin e pashfrytëzuar për qëllime ekonomike fitimprurëse për bashkinë. Çertifikata e Pronësisë me numër pasuror 139 në emër të bashkisë Elbasan përfshinë n/ngastrat pyjore nr.22a,22b, 22c, 23a, 23b, 24a, 24b, 25a, 25b dhe 25c në ekonominë pyjore ‘Zalli-Shkumbin’, të cilat sipas VKM nr.684, datë 02.09.2020 i kanë kaluar në pronësi bashkisë Elbasan me sipërfaqe totale prej 38.26 ha, por siç vërehet edhe nga çertifikata e pronësisë për pasurinë nr.139, ZK 1303 dhe nga matjet faktike që kanë kryer Specialistët e ASHK vendore Elbasan rezulton një shtesë në sipërfaqe prej 0,024 ha. Nga mbivendosja e të gjithë konturimeve përkatëse me koordinata gjeografike metrike të planvendosjeve përkatëse objekt i kontratave të qirasë për dhënien e fondit pyjor në përdorim brenda numrit të pasurisë 139, rezulton një sipërfaqe prej 5,65 ha e pa shfrytëzuar, e cila propozohet të jetë objekt i vendimit të Këshillit Bashkiak për shtesë me qëllimin e ushtrimit të veprimtarisë së vendosjes së paneleve fotovoltaike, me qëllim prodhimin e energjisë.

Duke parë dinamikën e ndryshimeve që pëson fondi pyjor përgjatë rrjedhës së Lumit Shkumbin, Bashkia Elbasan me qëllim ri-dimensionimin e ngastrave pyjore të ekonomisë pyjore Zalli-Shkumbin dhe për të pasur të dhëna sa më adekuate (përditësuara) mbi kategorinë e përdorimit të territorit të kësaj ekonomie pyjore dhe ndryshimet sipërfaqësore që ka pësuar ky fond, ka hartuar Planin e Mbarështimit të ekonomisë pyjore ‘Zalli-Shkumbin’ në vitin 2023, i cili ka marr miratimin e tij final pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM) me nr.23621, datë 04.04.2024.

Ndryshimet e pësuar mbi emërtesën e n/ngastrave pyjore, kategorinë e përdorimit të territorit dhe sipërfaqen përkatëse do jepen në tabelën bashkëlidhur këtij relacioni.

#### - **Avantazhet e përdorimit të impiantit Fotovoltaik:**

Energjia elektrike është një nevojë themelore për njeriun. Aktualisht prodhimi i energjise elektrike është bazuar tek lëndet djegëse fosile si nafta, qymyri, gazi dhe uji. Keto lende fosile janë të shtershme dhe djegia e tyre sjell efekte të demshme për mjedisin. Për shkak të këtyre kufizimeve dhe me rritjen e

vazhdueshme të kërkesës për energji elektrike alternative e vetme ngelet prodhimi i energjise elektrike nga burimet e rinovueshme të energjise. Burime të rinovueshme të energjise janë të shumta, si shfrytëzimi i energjise nga dielli i cili në një orë rrezaton energji të mjaftueshme, për të mbuluar konsumin e energjise të përdorur nga njerëzit në një vit. Tashme me teknologjite që disponojmë është zgjidhje e zgjuar dhe duhur të prodhojmë energji elektrike falas nga natyra. Avantazhi më i madh i energjise diellore kundrejt asaj hidro është impakti që ajo ka në mjedis. Në ndryshim nga hidrocentralet, impiantet fotovoltaikë nuk kanë asnjë lloj impakti negativ në mjedis, duke e bërë kështu një teknologji totalisht '*environmental friendly*'.

Gjithashtu, impiantet fotovoltaike kanë nevojë për një mirëmbajtje fare minimale. Thjesht pastrim i paneleve një herë në vit. Kjo do të thotë që pas investimit fillestar, energjia e prodhuar për të paktën 25 vitet në vijim është me kosto 0.

#### **Përshkrim i shkurtër i vendndodhjes, karakteristikave stacionale dhe rivlerësime**

N/ngastrat pyjore nr.22abc (23ac sipas PM 'Zalli-Shkumbin' v.2023), 24ab dhe 25a (25c sipas PM 'Zalli-Shkumbin' v.2023), të ekonomisë pyjore 'Zallin Shkumbin', në pronësi dhe administrim të Bashkisë Elbasan shtrihen në afërsi të fshatit Bujqës, Njësia Administrative Shirgjan, në anën e majtë të rrjedhjes së Lumit Shkumbin. Keto sipërfaqe janë kryesisht eroduar të grryera nga rrjedha e lumit, zona pa pyje toka boshe me bimësi të rrallë pyjore. Janë në zona me pjellori të ulët (zallishte), në vartësi të natyrës së aluvioneve toka është primitive e lumenjve dhe zallishteve, plotësisht e paformuar. Është tokë e cekët që shkon nga 30 deri në 60 cm, pothuaj e freskët, me reaksion neutral dhe teksturë argjilore.

Lëgusha mungon. Gurët në sipërfaqe, në 5% të saj.

Erozioni është i zhvilluar në thellësi në bregun e lumit.

Takohen ekzemplarë shumë të rrallë me llojet Shelg (*salix*), Vërrin (*alnus*) Plep (*populus*) dhe Rrap (*platanus*).

Bimësia barishtore (graminace).

Bimët me vlera mjeksore, eterovajore dhe industriale natyrore, mungojnë.

#### **Bashkëlidhur këtij relacioni gjeni materialin plotësues, i cili përmban:**

Sipërfaqen pyjore publike, të shprehur në (ha), në shkallën 1:25000, koordinata (gjatësi dhe gjërësi gjeografike, metrike) sipas sistemit 'Krgjsh'.

Treguesit identifikues të n/ngastrës, bazuar në të dhënat e regjistrimit kadastral pyjor dhe kullësor si dhe Planit të Mbarështrimit, identifikimin sipas listës së pronave, ekonomia, n/ngastra, sipërfaqja, qëllimi i përdorimit, treguesit kadastralë, etj.

Treguesit e vlerës për çdo njësi kadastrale të pyjeve dhe kullotave bazuar në vlerën dysheme të qerasë për ha/vit, të përcaktuar me VKM-në nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave

për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, i ndryshuar.

Sa sipër, *kërkojmë nga ana Juaj, miratimin për fillimin e procedurave për dhënien në përdorim të sipërfaqeve pyjore për një periudhë 10 vjeçare sipas ndryshimeve të propozuara.*

**KRYETARI**  
**Gledian Llatja**



*Konceptoi:*

A. Muça

*Pranoi:*

J. Bodurri

*Miratoi:*

K. Gripshi



BASHKIA ELBASAN  
AGJENCIA E PYJEVE, BUJQËSISË DHE MJEDISIT  
DREJTORIA E PYJEVE

**PËRMBLEDHËSE**  
**PËR DHËNIEN E FONDIT PYJOR NË PËRDORIM**  
**Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë.**

Nr.	Ngastra	Ekonomia pyjore	Përdorimi territorit	Qëllimi i dhënies në përdorim	Sipërfaqe në përdorim, (Ha)		
					Ha	lekë/ha/vit	lekë
1	23/a	Zalli-Shkumbin	Toke me bimesi pyjore	Për vendosje bazamentesh, stacionesh për panele fotovoltaike me qëllim prodhim energjie	4,3	143,000	6,149,000
2	23/c	Zalli-Shkumbin	Inproduktive		0,55	143,000	78,650
3	24a	Zalli-Shkumbin	Toke me bimesi pyjore		10,7	143,000	1,530,100
4	24b	Zalli-Shkumbin	Inproduktive		1,3	143,000	185,900
5	25c	Zalli-Shkumbin	Toke me bimesi pyjore		3,8	143,000	543,400
<b>TOTALI</b>					<b>20,65</b>		<b>8,487,050</b>

Shënim: Të dhënat e mësipërme janë vjelur nga PM të ekonomisë pyjore Zalli-Shkumbin të hartuar në vitin 2023, me ndryshimet përkatëse të ndodhura në territor (sipërfaqe, emërtesë n/ngastre, kategori përdorimi territori, etj.).

**Specialisti i Kadastrës**

Astrit Muça

**Përgjegjësi i Sektorit**

Jakov Bodurri

**DREJTORI**



Klajd Gripshi

# Planvendosja e tokes pyjore qe jepet ne perdorim me qira, Ek. pyjote "Zalli Shkumbin" Siperfaqja 20.65 ha

Sistemi koordinativ KRGJSH




X	Y	NR. Pike
502325.488	4549525.5291	1
502398.6264	4549365.845	2
502475.1857	4549238.7062	3
502659.1819	4549302.9028	4
502959.5561	4549329.7415	5
503123.7445	4549408.631	6
503213.7891	4549545.2658	7
503061.468	4549604.1633	8
502822.3472	4549588.1718	9
502779.4956	4549642.3309	10
502693.409	4549639.6875	11
502570.2354	4549549.6737	12
502459.757	4549507.8324	13

-  Pika me koordinata
-  Parcela Pyjore



Shkalla: 1:5,000





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKT - VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB NR.163, DATË 27.11.2020  
“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË FONDIT PYJOR  
PUBLIK” DHE VKB NR.124, DATË 26.09.2022 “PËR DHËNIEN NË PËRDORIM  
ME KONTRATË QIRAJE TË FONDIT PYJOR PUBLIK”**

- Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “e”;
- Ligjit nr.57, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, nenin 25 pika 1;
- VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit të Ministave nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, i ndryshuar;
- Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016 “Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik.
- VKB nr.163, datë 27.11.2020 “Për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor publik“.
- VKB nr.124, datë 26.09.2022 “Për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor publik“.

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D O S I**

1. Të bëj ndryshimet dhe shtesat në VKB nr.163, datë 27.11.2020 “Për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor publik” dhe VKB nr.124, datë 26.09.2022 “Për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor publik“ në ekonominë pyjore Zalli-Shkumbin, sipas listës bashkëlidhur.
2. Miratimin e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqes pyjore për qëllime vendosje panelesh fotovoltaikë për prodhimin e energjisë, me një afat 10 (dhjetë) vjeçar nga lidhja e kontratës.
3. Vlera vjetore dysheme për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të jetë sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, i ndryshuar.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës dhe Agjencia e Pyjeve, Bujqësisë dhe Mjedisit.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

**KRYETAR**  
**Lutfi LALA**

*Konceptoi:* Astrit Muça

*Pranoi:* Jakov Bodurri

*Miratoi:* Klajd Gripshi

*Konfirmoi:* Arben Hoxha





BASHKIA ELBASAN  
AGJENCIA E PYJEVE, BUJQËSISË DHE MJEDISIT  
DREJTORIA E PYJEVE

**PËRMBLEDHËSE**  
**PËR DHËNIEN E FONDIT PYJOR NË PËRDORIM**  
**Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë.**

Nr.	Ngastra	Ekonomia pyjore	Përdorimi territorit	Qëllimi i dhënies në përdorim	Sipërfaqe në përdorim, (Ha)		
					Ha	lekë/ha/vit	lekë
1	23/a	Zalli-Shkumbin	Toke me bimesi pyjore	Për vendosje bazamentesh, stacionesh për panele fotovoltaike me qëllim prodhim energjie	4,3	143,000	6,149,000
2	23/c	Zalli-Shkumbin	Inproduktive		0,55	143,000	78,650
3	24a	Zalli-Shkumbin	Toke me bimesi pyjore		10,7	143,000	1,530,100
4	24b	Zalli-Shkumbin	Inproduktive		1,3	143,000	185,900
5	25c	Zalli-Shkumbin	Toke me bimesi pyjore		3,8	143,000	543,400
<b>TOTALI</b>					<b>20,65</b>		<b>8,487,050</b>

Shënim: Të dhënat e mësipërme janë vjelur nga PM të ekonomisë pyjore Zalli-Shkumbin të hartuar në vitin 2023, me ndryshimet përkatëse të ndodhura në territor (sipërfaqe, emërtesë n/ngastre, kategori përdorimi territori, etj.).

**Specialisti i Kadastrës**

Astrit Muça

**Përgjegjësi i Sektorit**

Jakov Bodurri

**DREJTORI**



Klajd Gripshi

# Planvendosja e tokes pyjore qe jepet ne perdorim me qira, Ek. pyjote "Zalli Shkumbin" Siperfaqja 20.65 ha

Sistemi koordinativ KRGISH




X	Y	NR. Pike
502325.488	4549525.5291	1
502398.6264	4549365.845	2
502475.1857	4549238.7062	3
502659.1819	4549302.9028	4
502959.5561	4549329.7415	5
503123.7445	4549408.631	6
503213.7891	4549545.2658	7
503061.468	4549604.1633	8
502822.3472	4549588.1718	9
502779.4956	4549642.3309	10
502693.409	4549639.6875	11
502570.2354	4549549.6737	12
502459.757	4549507.8324	13

-  Pika me koordinata
-  Parcela Pyjore



Shkalla: 1:5,000



4550000  
4549800  
4549600  
4549400  
4549200  
4549000  
502500  
502600  
502700  
502800  
502900  
503000  
503100